

EPOKA

E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6437
E martë, 12 tetor 2021
çmimi 0.40 €

FUSHATA ZGJEDHORE PO SHKON DREJT FUNDIT, SUBJEKTET POLITIKE VAZHDOJNË SHKELJEN E MASAVE KUNDËR COVIDIT | FAQE 4-5



PARTITË POLITIKE NUK I RESPEKTOJNË MASAT KUNDËR COVIDIT



Subjektet politike nuk janë duke i respektuar masat kundër Covidit gjatë fushatës zgjedhore. Kështu kanë deklaruar përgjithësisht se nuk ka shqiptuar asnjë dënim për partitë gjatë fushatës. IKShPK-ja ka paralajmëruar se mosrespektimi i këtyre masave mund të ndikojë në rritjen e rasteve me Covid.



SPECIALJA URDHËRON POLICINË E KOSOVËS TË PËRGJIGJET NËSE SIGURON MBROJTJEN NË LIRI TË ISH-KRERËVE TË UÇK-së | FAQE 3



Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

RENOVA
PUTZ

Makedoni Xheqishti-Tetovë
Gurëz-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
E-mail: renova@mt.net.mk +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200 Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.

NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com



Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVO
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

infinity

INFINITY
Digital Agency

Internet Website,
Marketing...

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com
Gazeta "Epoka e re"](https://facebook.com/Gazeta%22Epoka%20e%20re%22)



OPINION

MANIPULIM I SHIFRAVE TË RRITJES SË GDP-së | FAQE 8

Shkruan:
Dardan SEJDIU



AKTUALE



KOSOVA DHE SHQIPËRIA SHTOJNË BASHKËPUNIMIN PARLAMENTAR | FAQE 6

KOSOVA HYN NË FAZËN E DYTË TË ZBATIMIT TË MSA-së | FAQE 6

EKONOMI

MURATI: SHTETI DO TA GARANTOJË PUNËSIMIN E SECILIT TË RI QË HYN NË TREGUN E PUNËS | FAQE 8

PDK-JA KËRKON NGA QEVERIA TË RISHIKOJË VENDIMIN PËR PROJEKTIN AMERIKAN TË GAZSJELLËSIT | FAQE 8

SPORT



KOSOVA KËRKON FITORE NDAJ GJEORGJISË | FAQE 12

Shqipërisë i kërkohet anulimi i Agjencisë për Media dhe Informim

TIRANË, 11 TETOR - Aleanca për Liri të Mediave dhe Përgjigje të Shpejtë i ka kërkuar Partisë Socialiste në Shqipëri që të heqë dorë menjëherë nga planet për themelim të Agjencisë për Media dhe Informim në mënyrë që të mos ketë kontroll të plotë mbi informacionin publik në këtë shtet. "Ne, po ashtu, i bëjmë thirrje Bashkimit Evropian që menjëherë të angazhohet me qeverinë shqiptare për të diskutuar këto shqetësimë, si çështje me prioritet në bisedimet për anëtarësim", ka thënë aleanca, e cila përbëhet nga gjashtë organizata ndërkombëtare të cilat merren me liri të mediave dhe të drejta të gazetarëve në botë.

Aleanca për Liri të Mediave dhe Përgjigje të Shpejtë është krijuar më 2020 dhe financohet nga Komisioni Evropian. Sipas saj, planet për kujtim të Agjencisë për Media dhe Informim në Shqipëri, të shpalosura gjatë sesionit të parë të legislaturës së re në Parlamentin e Shqipërisë më 18 shtator, mund ta centralizojnë kontrollin mbi marrëdhëniet publike të qeverisë në një entitet të vetëm. "Sipas vendimit, zëdhënësit e ministrite dhe të departamenteve qeveritare do të ndalojen që të flasin drejtëpërdrejt me mediat dhe informacioni publik apo komentet do të duhet të miratohen nga drejtori i

përgjithshëm i Agjencisë i cili do të emërohet nga kryeministri dhe do ta ketë pozitën e barabartë me atë të një ministri qeveritar", ka thënë aleanca përmes një deklarate.

Aty është përmendur se kushdo që mban pozitën e drejtorit të përgjithshëm do të mund të emërojë apo shkarkojet zëdhënësit në secilën ministri dhe do t'u miratojë paraqitjet publike apo intervistat.

Organizatat që janë pjesë e aleancës besojnë se ndonëse qeveria shqiptare, në krye me Edi Ramën, ka thënë se duke finansuar këtë Agjenci me buxhet shtetëror, do ta rrisë transparencën, në fakt mund të ndodhë e kundërtë. "Gazetarët në Shqipëri janë duke punuar aktualisht në kushte jashtëzakonisht të vështira për të pasur qasje në informacion nga burimet qeveritare. Qeveria komunikon me gazetarët përmes grupeve në platformën 'WhatsApp', në vend që të përdorë kanale zyrtare. Gazetarët që punojnë për media të pavarura diskriminohen vazhdimit kur kërkojnë informacione nga ministrat. Gazetarëve që shihen si përfaqësues të 'opozitës' nuk u mundësohet akreditimi dhe u mohohet bërja e pyetjeve në konferencë për media".

Kjo Aleancë ka theksuar edhe se kryeministri Rama nuk organizon



konferencë për media dhe varet nga stacioni i tij televiziv ERTV për të shpërndarë tone të deklaratave të tij për mediat dhe se "intervistat jepen vetëm për gazetarë të caktuar, duke shërbyer si mburojë për kryeministrin dhe ministritë e

tjera që të mos përballen me pyetje sfiduese".

Kryeministri Rama ka fituar një mandat të tretë në krye të Qeverisë së Shqipërisë dhe kabineti i tij është betuar javë më parë.

Kabineti i mandatit të tretë qeverisës të socialistëve përbëhet nga 15 ministri, nga të cilët katër ministra pa portofol. Dymbëdhjetë ministri do të drejtohen nga gratë dhe tri të tjera nga burrat.

Bën betimin kancelari i ri i Austrisë



Vjen, 11 tetor - Diplomati austriak Alexander Schallenberg u betua të hënën në postin e kancelarit të Austrisë.

Dy ditë më parë, paraardhësi i tij, Sebastian Kurz, dha dorëheqje për shkak të një hetimi për korruption kundër tij. "Ne të gjithë presim që qeveria tanë t'i kthehet punës dhe së bashku t'i çojmë gjërat përpara", tha

presidenti i Austrisë, Alexander Van der Bellen, i cili kryesoit ceremoninë e betimit të kancelarit të ri.

Schallenberg, 52 vjeç, anëtar i Partisë Popullore të Austrisë, ka shërbyer si ministër i Jashtëm qysh në vitin 2019.

Ambasadori i Austrisë në Francë, Michael Linhart, do ta marrë tanë postin e ministrit të Jashtëm.

Kurz është nën hetime pasi dyshohet se ka përdorur fondet e qeverisë për të paguar reklama në një gazetë, në këmbim të mbulimit pozitiv të aktiviteteve të tij.

Kurz ka mohuar keqbërjet. Ai ka dhënë dorëheqje, pasi partnerja e koalicionit, Partia e Gjelbër, ka kërcënuar se do të tjerhiqet për shkak të skandalit.

Çmimi Nobel për Ekonomi ndahet për studime në jetën reale

STOKHOLM, 11 TETOR - David Card, Joshua Angrist dhe Guido Imbens janë shpërblyer të hënën me Çmimin Nobel për Ekonomi për vitin 2021. Akademia e Shkencave në Suedi ka thënë se çmimi është ndarë për "nxjerjen e përfundimeve nga eksperimente të paqëllimshme". Sipas saj, puna e laureatëve bashkërisht ka "riformësuar punën empirike në studimet për ekonomi". Ata është thënë se përmes


"eksperimenteve natyrore" kanë kuptuar si lidhen politikat ekonomike dhe ngjarjet e tjera. Eksperimentet natyrore bazohen në situata të jetës reale për të kuptuar ndikimin në vendimet qeveritare. Card ligjeron ekonomi në Universitetin e Kalifornisë në Bërkli. Angrist ligjeron në Institutin Massachusetts për Teknologji në Kembrixh. Imbens ligjeron në shkollën për

biznes në Universitetin Stanford.

Për dallim nga çmimet e tjera Nobel, ai për ekonomi nuk është krijuar me dëshirë të Alfred Nobelit, por nga Banka Qendrore e Suedisë, si kujtim për të më 1968.

Fituesi i parë është shpallur më vonë gjatë atij viti.

Çmimi Nobel për Ekonomi është i fundit që bëhet publik për dallim nga çmimet në kategoritë e tjera.



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

- Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
- ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
- Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Specialja urdhëron Policinë e Kosovës të përgjigjet nëse siguron mbrojtjen në liri të ish-krerëve të UÇK-së

HAGË, 11 TETOR - Dhomat e Specializuara për Kosovën në Hagë kanë lëshuar një urdhër për Policinë e Kosovës që të përgjigjet në detaje nëse ky institucion i sigurisë mund të sigurojë mbrojtjen në liri të ish-krerëve të UÇK-së që po mbahen që gati një vjet të paraburgosur në Hagë. Policia e Kosovës, sipas urdhrit të lëshuar më 8 tetor nga Haga, ka dy javë kohë, që nga kjo datë, të përgjigjet për kërkësën e Dhomave të Specializuara për Kosovën. Në dokumentin e lëshuar nga gjyqtari francez, Nicolas

Guillou, është thënë se Policia e Kosovës urdhërohet, po ashtu, që ta respektojë konfidentialitetin dhe përbajtjen e procedurës. Ish-drejtuesit e UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi, Jakup Krasniqi, akuzohen nga Haga për krimelufte në Kosovë. Vendimin e fundit të Panelit të Gjyqtarëve të Apelit lidhur me apelet e avokatëve mbrojtës të të akuzuarve kundër vendimeve të gjykatësit të procedurës paraprake përrishimin e mbajtjes së tyre në paraburgim, u zbulua se

Drejtoria e Policisë së Kosovës nuk kishte dhënë garancitë e mjaftueshme për mbrojtjen në liri të ish-eprorëve të UÇK-së të cilët tash e njëmbëdhjetë muaj po mbahen në paraburgim në Hagë. "Paneli konstaton se nëse gjyqtari i procedurës paraprake konsideron se përgjigja nga Policia e Kosovës nuk ishte mjaftueshmë e kënaqshme, atëherë ai duhet të kishte kërkuar nga drejtori i polisë për ta marrë përgjigjen e detajuar që konsideronte se mungonte", është thënë në vendimin e Panelit.



Kosova hyn në fazën e dytë të zbatimit të MSA-së

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 TETOR - Të hënën është mbajtur mbledhja e dytë e Këshillit Ministror për Integrin Evropian mbi planin e veprimit për zbatimin e Agjendës për Reforma Evropiane ERA II. Në hapje të mbledhjes, kryeministri Albin Kurti ka theksuar punën e rëndësishme drejt zbatimit të fazës së dytë të prioriteteve për integrin në Bashkimin Evropian, të dakorduara së bashku me Bashkimin Evropian. "Meqë tani Kosova ka hyrë në fazën e dytë të zbatimit të Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asociim, këto prioritete janë kritike përrugën tonë drejt integrimit të plotë në Bashkimin Evropian. Me zbatimin e tyre ne do ta përmirësojmë funksionimin e institucioneve tona, do ta forcojmë shtetin e së drejtës dhe të do krijojmë më tepër hapësirë



e mundësi për vende të reja punë e zhvillim të qëndrueshmë ekonomik", ka thënë

kryeministri Kurti, duke theksuar se këto janë edhe prioritetet e programit

qeverisës. Gjatë takimit u diskutua rrëth detyrave konkrete dhe sfidave të

mundshme gjatë dy vjetëve të ardhshme të zbatimit të Agjendës për Reforma Evropiane. Të pranishëm ishin edhe zëvendëskryeministri i parë për Integrin Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Besnik Bislimi, zëvendëskryeministria e tretë për Çështje të Pakicave dhe të Drejtave të Njeriut, Emilija Rexhepi, anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar dhe përfaqësues të institacioneve dhe agjencive të pavarura. Zyra e zëvendëskryeministrit për Integrin Evropian, Zhvillim dhe Dialog, së bashku me drejtoritë përkatëse të integrimit evropian, do ta monitorojnë rregullisht procesin e zbatimit të reformave dhe do të bashkëpunojë ngushtë me ministritë, Kuvendin e Kosovës, këshillat dhe agjencitë e pavarura përmbrashjen e obligimeve të Agjendës për Reforma Evropiane.

Vendimi për pagimin e rrymës në veri, i kundërligjshëm

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 11 TETOR - Vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji Elektrike (ZRRE) në Kosovë që t'u paguhet rryma qytetarëve të katër komunave me shumicë serbe në veri të Kosovës për periudhën 2012-2017, është anuluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Vendimi është anuluar pas ankesës së Avokatit të Popullit të Kosovës. Sipas njoftimit, Gjykata Themelore e ka detyruar Shërbimin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS) që të

bëjë kthimin e mbi 40 milionë eurove për t'ua kompensuar dëmin konsumatorëve që janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Kosovës për periudhën kohore nga 06.02.2012 deri më 20.10.2017 në vlerë prej 40.855.480 milionë eurosh", thuhet në njoftimin e Gjykatës. Banorët e komunave me shumicë serbe: Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan nuk i paguajnë faturat e rrymës që nga përfundimi i luftës në Kosovë më 1999. Reth 8 milionë euro në vit llogaritet të jetë borxhi që bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht

kompensimin e dëmit konsumatorëve që janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Kosovës për periudhën kohore nga 06.02.2012 deri më 20.10.2017 në vlerë prej 40.855.480 milionë eurosh", thuhet në njoftimin e Gjykatës. Banorët e komunave me shumicë serbe: Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveçan nuk i paguajnë faturat e rrymës që nga përfundimi i luftës në Kosovë më 1999. Reth 8 milionë euro në vit llogaritet të jetë borxhi që bëjë kthimin e shumës së faturuar, respektivisht

Fatura - Bill			
Suma Muaj	Curr. Price (€/cent)	Shuma Iznos (€)	Valuta
16596.00		2.72	EUR
44236.00		4.21	
16503.00		2.93	
43978.00		4.44	
87.00		0.00	
266.00		0.00	
87.00		0.00	
266.00		0.00	
87.00		0.00	
266.00		0.00	
1			
R2			
1151			
04			
1			
2			
3			
4			
5			
6			
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			
51			
52			
53			
54			
55			
56			
57			
58			
59			
60			
61			
62			
63			
64			
65			
66			
67			
68			
69			
70			
71			
72			
73			
74			
75			
76			
77			
78			
79			
80			
81			
82			
83			
84			
85			
86			
87			
88			
89			
90			
91			
92			
93			
94			
95			
96			
97			
98			
99			
100			
101			
102			
103			
104			
105			
106			
107			
108			
109			
110			
111			
112			
113			
114			
115			
116			
117			
118			
119			
120			
121			
122			
123			
124			
125			
126			
127			
128			
129			
130			
131			
132			
133			
134			
135			
136			
137			
138			
139			
140			
141			
142			
143			
144			
145			
146			
147			
148			
149			
150			
151			
152			
153			
154			
155			
156			
157			
158			
159			
160			
161			
162			
163			
164			
165			
166			
167			
168			
169			
170			
171			
172			
173			
174			
175			
176			
177			
178			
179			



FUSHATA ZGJEDHORE PO SHKON DREJT FUNDIT, SUBJEKTET POLITIKE
VAZHDOJNË SHKELJEN E MASAVE KUNDËR COVIDIT

Partitë politike nuk i respektojnë masat kundër Covidit

Subjektet politike nuk janë duke i respektuar masat kundër Covidit gjatë fushatës zgjedhore. Kështu kanë deklaruar për gazetën "Epoka e re" monitoruesit e fushatës zgjedhore. Ata kanë ftuar subjektet politike që t'i respektojnë masat që parandalojnë përhapjen e pandemisë Covid-19, duke vlerësuar se mbi çdo garë apo kauzë politike duhet të qëndrojnë jeta dhe shëndeti i qytetarëve. Pavarësisht prej shkeljeve të këtyre masave, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK) nuk ka shqiptuar asnjë dënim për partitë gjatë fushatës. IKShPK-ja ka paralajmëruar se mosrespektimi i këtyre masave mund të ndikojë në rritjen e rasteve me Covid

Muhamed KOCI

PRISHTINË, 11 TETOR - Monitoruesit e fushatës për zgjedhjet lokale të 17 tetorit kanë vlerësuar se partitë politike nuk janë duke i respektuar masat kundër

Covidit gjatë aktiviteteve të tyre elektorale. Ata kanë ftuar institucionet përgjegjëse që ta sanksionojnë secilin subjekt politik që nuk i respekton masat në fuqi.

Allen Meta nga Institut Demokraci për Zhvillim (D4D), ka thënë se gjatë monitorimit

të kësaj fushate janë vërejtur parregullsi në respektimin e masave në fuqi. "Që nga fillimi i fushatës zgjedhore Institut Demokraci për Zhvillim (D4D) ka qenë i angazhuar për monitorimin e fushatës zgjedhore. Në zgjedhjet lokale të vitit 2021, D4D fokus të

veçantë i ka dhënë fushatës zgjedhore e cila po bëhet në rrjete sociale, duke e monitoruar me vëmendje diskursin i cili përdoret nga partitë politike në rrjetet e tyre sociale. Pashmangshmërisht gjatë kësaj fushate kemi ndjekur me vëmendje edhe mbajtjen e aktiviteteve dhe tubimeve të ndryshme, ku në raste të ndryshme kemi vërejtur edhe parregullsi dhe shkelje të masave kundër Covidit, mirëpo kjo pastaj bie nën kompetencën e institucioneve relevante për monitorim dhe sanksionim në raste kur nuk ka respektim të masave kundër Covidit", ka thënë Meta.

Ai ka bërë thirrje që edhe gjatë ditëve të fushatës që kanë mbetur të respektohen në

përpikëri masat për parandalimin e përhapjes së pandemisë. "Duke qenë se masat janë për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, ne bëjmë thirrje që edhe gjatë këtyre katër ditëve të mbeturë të fushatës zgjedhore të bëhet respektim strikt i masave kundër Covidit. Në të njëjtën kohë bëjmë thirrje që edhe gjatë ditës së zgjedhjeve e njëjtë të vazhdojë duke respektuar masat të cilat janë publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve mbi procesin e votimit e në të njëjtën kohë edhe duke respektuar masat", ka deklaruar Meta.

Pavarësisht prej këtyre shkeljeve, Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë e Kosovës (AUVK) ende nuk ka shqiptuar

Bëhet thirrje që të punohet më shumë për çështjen e shëndetit mendor

PRISHTINË, 11 TETOR - Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, organizuan një konferencë të hënën për shënimin e Ditës Botërore të Shëndetit Mendor. Qëllimi i konferencës ishte rritja e ndërgjegjësimit të publikut për standardet evropiane në fushën e vendosjes së pavullnetshme në institucionet të mbyllura psikiatrike të personave me çregullime mendore të privuar nga liria. Referencia do t'i bëhet nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDN) mbi Ndalinin e Torturës, Trajtimit ose

Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruar.

Konferanca u organizua në vazhdën e gjetjeve dhe rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) dhe të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) i Avokatit të Popullit pas vizitave të tyre të shumta në institucionet e mbyllura psikiatrike.

Frank Power, shef i Zyrës së Këshillit Evropian në Prishtinë, ka thënë se kjo konferencë ka mbledhur të gjithë hisedarët që punojnë për çështjen e shëndetit mendor për të diskutuar për punën e tyre dhe

për hapat që duhen ndërmarrë në mënyrë që shëndeti mendor të bëhet realitet për qytetarët. "Përkrasha e shëndetit mendor përfshin një gamë të gjërë, por konferanca e sotme, e organizuar së bashku me Institucionin e Avokatit të Popullit, fokusohet në një çështje më specifike, që është edhe çështja më sfiduese dhe më komplekse në shëndetin mendor, e që është vendosja e pavullnetshme në hapësirat e mbyllura të personave me çregullime mendore të shëndetit mendor", ka dekluarar Power. Avokati i Popullit, Naim Qelaj, ka thënë se në Ditën Botërore

të Shëndetit Mendor është një mundësi që qeveritë, organizatat e shoqërisë civile dhe shumë të tjerë të bisedojnë për hapat që janë ndërmarrë për të siguruar një ambient që kuption, pranon dhe luan rol aktiv në krijimin e një shoqërie që gjëzon shëndet mendor. "Është evidente që personat me çregullime të shëndetit mendor bëjnë pjesë në grupet e cenueshme dhe të ndjeshme dhe shkelje të rëndë të drejtave të njeriut, diskriminim dhe stigmatizim, sidomos kur trajtimi dhe vendosja në institucionet të shëndetit mendor apo edhe në kushtet

paraburgimi është i pavullnetshëm", ka thënë Qelaj. Dita Botërore e Shëndetit Mendor është shpallur nga OKB-ja dhe shënohet çdo 10 tetor, ndërsa sivjet shënohet me moton: "Kujdesin për shëndetin mendor për të gjithë: Ta bëjmë realitet". Në të gjithë botën më shumë se 450 milionë njerëz vuajnë nga çregullimet mendore. Organizata Botërore e Shëndetit vlerëson se rreth 151 milionë njerëz vuajnë nga depresioni, 26 milionë vuajnë nga skizofrenia dhe 125 milionë vuajnë nga çregullimet që lidhen me alkoolin.



asnje dënim për partitë gjatë fushatës. Zëdhënësi i kësaj agjencie, Lamir Thaçi, ka thënë për gazeten "Epoka e re" se mbi çdo garë apo kauzë politike duhet të qëndrojnë jeta dhe shëndeti i qytetarëve. "Deri më tanë nga AUV nuk ka shqiptuar një gjobë për subjektet politike. Si autoritet ligjzbatues u bëjmë apel të gjitha subjekteve politike dhe kandidatëve që garojnë për kryetar të komunave dhe asamble komunale që gjatë gjithë kohës të kenë parasysh zbatimin e masave kundër Covidit. Mbi çdo garë apo kauzë politike qëndron jeta dhe shëndeti i qytetarëve. Andaj askush nuk ka të drejtë të bëjë veprime të cilat bien në kundërshtim me ligjin dhe që rrezikojnë

shëndetin publik", ka thënë Thaçi.

Ai ka treguar se inspektorët sanitari kanë për obligim të veprojnë në se cilën shkelje të masave kundër Covidit. "Inspektorët sanitari janë të pavarur në punën e tyre në terren dhe kanë për obligim të veprojnë në se cilën shkelje që hasin. Varësish nga lloji i shkeljes, personi që haset si shkelës në kategorinë e personit juridik ose personit individual, person përgjegjës, lartësia e gjobës është e përcaktuar me Ligjin Kundër Covidit", ka thënë Thaçi

IKShPK-ja paralajmëron rritje të rasteve me Covid

Në javën e fundit të fushatës zgjedhore, edhe Institutit

Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka kërkuar respektim e masave kundër Covidit.

IKShPK-ja ka paralajmëruar se mosrespektimi i këtyre masave mund të ndikojë në rritjen e rasteve me Covid. "IKShPK apelon te të gjithë qytetarët, institucionet dhe organizatat publike dhe private, për respektimin dhe ndërmarrjen e të gjitha masave të nevojshme për parandalimin, menaxhimin dhe kontrollin e infeksionit Covid-19, duke marrë parasysh dispozitat e Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid-19 dhe vendimet në fuqi mbi masat dhe obligimet e institucioneve për zbatimin e masave të përgjithshme dhe specifike përmbrojtjen nga pandemia

Covid-19", është thënë në njoftim e institutit.

IKShPK-ja ka bërë thirrje që qytetarët të vazhdojnë të vaksinohen. "Personat e pavaksinuar janë brengë jonë më e madhe. Vaksinimi është metoda më e mirë, më e lirë dhe më efikase në luftën kundër Covid-19", ka vlerësuar IKShPK-ja, duke shtuar se vaksinimi është alternativa e vetme për ta ndalur përhapjen e pandemisë.

"Nëse nuk vaksinohemi mund të rriten rastet e reja duke u përcjellë me shtim të hospitalizimeve, vdekjeve,

mbingarkesë të sistemit shëndetësor, rikthim të kufizimeve, goditje të shëndetit mental, shkollës, ekonomisë, kulturës, artit e sportit", është thënë në njoftimin e IKShPK-së. Për shkak të situatës me

pandeminë Covid-19, partitë politike kanë ndryshuar fushatën zgjedhore. Duke u fokusuar në fushata digitale dhe takime të vogla me qytetarë, kandidatët i kanë informuar qytetarët me pikat kryesore të programeve të tyre. Por, në pjesën e fundit të fushatës zgjedhore, partitë politike kanë shtuar aktivitetet elektorale.

Në tubimet e shumë kandidatëve janë parë grupe të mëdha të qytetarëve, duke mos respektuar asnjë masë kundër Covidit.

Rrjetet sociale, sidomos platformat "Facebook" dhe "Instagram", së bashku me debatet televizive, janë rrjetet dhe kanalet më të përdorura për publikimin e platformave politike deri më tanë.

Arrestohen dy persona për fajde dhe shpëlarje të parave

PRISHTINË, 11 TETOR - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka njoftuar se me urdhër të kësaj prokurorie është zhvilluar një operacion për bastisje në lokacione të ndryshme, në Prishtinë dhe Fushë-Kosovë, ku janë arrestuar dy persona me inicialet R. J dhe H. D. Prokuroria Speciale ka njoftuar

se operacioni është zhvilluar nga Policia e Kosovës, respektivisht Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korruption, me ç'rast kanë arrestuar të pandehurin R. J. për shkak të dyshimit se ka kryer veprën penale "Fajde" nga neni 331, paragrafi 3, lidhur me neni 31 të KPRK-së dhe veprën penale "Shpëlarja e

parave" nga neni 302 i KPRK-së, lidhur me neni 56, paragrafi 1 dhe 2 i Ligjit nr. 03/L-96 për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. "Po ashtu, me urdhër të kësaj prokurorie nga Policia e Kosovës është arrestuar edhe personi me inicialet H. D. për shkak të dyshimit se ka kryer veprën

penale 'Fajde' nga neni 331, paragrafi 3, lidhur me neni 31 të KPRK-së. Gjithashtu, ju njoftojmë se dy personat e arrestuar janë dërguar në mbajtje, si dhe në cilësi të provave materiale janë sekuestruar 3 130 euro, dy telefona, si dhe 40 dollarë", ka njoftuar Prokuroria Speciale e Kosovës.



Kosova dhe Shqipëria shtojnë bashkëpunimin parlamentar

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

TIRANË, 11 TETOR - Në kuadër të bashkëpunimit në mes të Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës se Shqipërisë është mbajtur në Tiranë tryesa e parë e kryetarëve të Komisioneve të Kuvendit të Shqipërisë dhe Kuvendit të Kosovës. Kjo tryezë është organizuar si rezultat i vizitës së parë zyrtare të kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla, në Kosovë dhe diskutimeve të fryshtme me kryetarin e Kuvendit, Glauk Konjufca.

Tryesa i ka filluar punimet me fjalimin përshtendetës nga kryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, Lindita Nikolla. Në fjalën e saj hyrëse, kryetarja Nikolla ka thënë se Kuvendi i Shqipërisë dhe Kuvendi i Kosovës sapo kanë nisur një kapitull të ri bashkëpunimi intensiv dhe se tryesa e parë e kryetarëve të komisioneve është hapi i parë i institucionalizimit të

bashkëpunimit parlamentar. Ajo ka shtuar se paralelisht me këtë tryezë, në grupet e punës të të dy kuvendeve, nën drejtimin e sekretarëve të përgjithshëm, është duke u finalizuar marrëvesha e bashkëpunimit midis të dy kuvendeve. "Kjo tryezë është një kantier pune i të zgjedhurve të kombit shqiptar, për të diskutuar për t'u shërbyer më mirë bashkëkombësve e qytetarëve tanë, kudo ku ndodhen. Është koha të shtojmë, shumëfishojmë kontaktet dhe zgjerojmë bashkëpunimin vëllazëror midis dy kuvendeve tona", ka theksuar Nikolla.

Nga ana tjetër, kryetarët e komisioneve parlamentare të dy kuvendeve gjatë diskutimeve të tyre theksuan aspekte të ndryshme të bashkëpunimit parlamentar, duke iu referuar fushëveprimit të komisioneve përkatëse në procesin legjislativ dhe përafrimin e legjisacionit, për ta lehtësuar bashkëpunimin midis institucioneve, sektorit privat dhe qytetarëve.

Diskutimet kryesisht u fokusuan



në bashkëpunimin përrafrimin e legjisacionit të të dy vendeve me legjisacionin e Bashkimit Evropian në fushën e ekonomisë, financave publike, investimeve, shkëmbimeve tregtare, sigurisë dhe mbrojtjes, arsimi, kërkimit shkencor, kulturës, medias, shëndetësisë dhe mbrojtjes

sociale, bashkëpunimit me diasporën, mbështetjes së veprimtarive prodhuese e sipërmarrjes private, administratës publike, bujqësisë e zhvillimit rural, mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, infrastrukturës dhe transportit, energjisë, qeverisjes vendore.

Kryetarët e komisioneve parlamentare u pajtuan që, përvèç takimeve në nivel Kuvendesh, bashkëpunimi të zgjerohet dhe e thellohet edhe midis komisioneve përkatëse dhe rezultatet e tyre të paraqiten e të diskutohen në tryezat e përbashkëta të cilat do të mbahen në mënyrë periodike.

Kurti kërkon që serbët të mos i nënshtrohen presionit gjatë votimit



PRISHTINË, 11 TETOR - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u ka bërë thirje serbëve të Kosovës që të mos i nënshtrohen presionit dhe frikësimit gjatë votimit përzgjedhjet lokale. "Duke qenë në prag të zgjedhjeve lokale, është e rëndësishme që të kemi zgjedhje të lira dhe demokratike, ku secili qytetar i Republikës voton mbi bazën e bindjeve personale", ka thënë Kurti gjatë një takimi që ka zhvilluar me përfaqësuesin e posaçem të Kombeve të

Bashkuara në Kosovë, Zahir Tanin. Kosova mban zgjedhjet lokale të dielën, më 17 tetor. Qytetarët me të drejtë vote do të mund t'i zgjedhin kryetarët e rinj të 38 komunave dhe përfaqësuesit e asambleve komunale. Në të kaluarën misionet e Bashkimit Evropian për vëzhgimin e zgjedhjeve kanë thënë se qytetarët serbë, që nuk e kanë përkrahur Listën Serbe, janë frikësuar. Të gjitha komunat me shumicë

serbe në Kosovë aktualisht udhëhiqen nga partia Lista Serbe e cila gjëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar. Më herët, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiç, ka thënë se të gjithë kandidatët që nuk i përkasin Listës Serbe nuk do ta kenë përkrahjen e shtetit të tij. Një ditë më parë ai u ka bërë thirje serbëve të Kosovës që të bashkohen dhe të dalin në numër sa më të madh në zgjedhjet e 17 tetorit.

Njësia e FSK-së fitoi medaljen e argjendtë në Mbretërinë e Bashkuar

LONDËR, 11 TETOR - Në konkurrencë me mbi njëqind ekipe të forcave të shteteve të ndryshme të botës, njësiti i FSK-së zuri vendin e dytë dhe fitoi

medaljen e argjendtë në ushtrimin prestigjioz ndërkombëtar "Cambrian Patrol 2021" në Mbretërinë e Bashkuar. Ky ushtrim tejet sfidues organizohet për çdo

vit në Uells të Mbretërisë së Bashkuar ku marrin pjesë njësitet më të mira nga ushtria britanike nga shumë vende të tjera. Falë bashkëpunimit të ngushtë

bilateral me Mbretërinë e Bashkuar, kjo është hera e katërt që pjesëtarët e FSK-së marrin pjesë duke arritur këtë sukses të jashtëzakonshëm.



Bosch: Serbia e ndihmuar nga Lajçaku po shton presionin ndaj Kosovës për asociacionin



PRISHTINË, 11 TETOR - Ish-ambasadori i Holandës në Kosovë, Robert Bosch, ka thënë se Serbia me ndihmën e emisarit të BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, po shton presionin

ndaj Kosovës për të vazhduar me Asociacionin e Komunave Serbe. Sipas tij, Kosova duhet të jetë e fortë dhe ta zbatojë vetëm asociacionin e ndryshuar nga Gjykata Kushtetuese. "Me ndihmën e

Lajçakut, Serbia po shton presionin ndaj Kosovës për ta vazhduar Asociacionin e Komunave Serbe. Kosova duhet të jetë e fortë dhe të zbatojë vetëm Asociacionin e Komunave Serbe të ndryshuar

nga Gjykata Kushtetuese. Kjo është gjëja e duhur për të bërë në vendin ku sundimi i ligjit ka përparësi. Kjo duhet theksuar ndaj të gjitha vendeve mike", ka shkruar Bosch në llogarinë e vet në "Facebook".

Shpallet konkursi për rekrutimin e kandidatëve të rinj për shkollim në akademitë ushtarake të ShBA-së

PRISHTINË, 11 TETOR - Ministria e Mbrojtjes ka njoftuar të gjithë të interesuarit për shpalljen e konkursit për rekrutimin e kandidatëve të rinj për shkollim në Akademitë Ushtarake West Point dhe Akademinë e Forcave Ajrore dhe Akademinë e Forcave Detare të ShBA-së. Siç theksohet në komunikatë, kandidatët e përzgjedhur për kadetë do ta nënshkruajnë kontratën e shkollimit me FSK-në me të cilën përcaktohen obligimet që ata do të marrin si kadetë të FSK-së, si mbajtja e standardeve të larta të shkollimit akademik, gjendjes fizike, sjelljes dhe disiplinës. Mospërmbushja e obligimeve të parapara me kontratë në


cilindo vit të shkollimit do të rezultojë me humbjen e statusit të kadetit. Ministria e Mbrojtjes gjatë procesit të testimit ka bërë me dije se kandidatët duhet t'i zbatojnë të gjitha masat dhe rekomandimet e IKShPK-së përkicazi me parandalimin e përhapjes së Covid-19. Ministria e Mbrojtjes iu shërbën të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet e të rinjve dhe të rejave për shërbim në FSK, pa dallim race, ngjyre, feje, gjinie, përkatësie etnike dhe orientimi seksual. Konkursi është i hapur prej 11.10.2021 deri më 25.10.2021, ora 23:59", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



RrGK fillon fushatën "Voto për më shumë gra në zgjedhje lokale"

PRISHTINË, 11 TETOR - Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ka filluar fushatën "Voto për më shumë gra në zgjedhjet lokale". RrGK-ja ka njoftuar se rreth 80 vullnetarë nga e hëna në të premten (11-15 tetor) do të shkojnë çdoderë për të diskutuar me gratë dhe burrat mbi rëndësinë e votimit të më shumë grave në zgjedhjet që do të mbahen më 17 tetor. "Rreth 80 vullnetarë për pesë ditë (11-15 tetor) do të bisedojnë me qytetarë duke shkuar derë më derë në 21 komuna të Kosovës për të diskutuar me gratë dhe burrat votues mbi rëndësinë e votimit të më shumë grave në zgjedhjet lokale që do të mbahen më 17 tetor 2021. Ligji për Barazi Gjinore (LBGj) garanton përfaqësim të barabartë gjinor në të gjitha

fushat, përfshirë atë politike. Mirëpo, në kundërshtim me këtë ligj, deri më sot, as partitë politike e as komunat nuk kanë siguruar pjesëmarrje të barabartë të grave dhe burrave në sferën publike. Prandaj, na mbetet neve si qytetarë ta arrijmë barazinë", thuhet në komunikatën e RrGK-së. Më tutje, RrGK-ja i ka inkurajuar qytetarët që të votojnë për gratë duke theksuar se ato të përfaqësojnë më së miri interesat e tyre në komuna. "RrGK inkurajon të gjithë qytetarët që të votojnë për gratë të cilat do të përfaqësojnë më së miri interesat e tyre në komuna dhe në kuvende komunale si dhe do të përpilen përritjet e barazisë gjinore", është thënë në komunikatën e RrGK-së.



Kosova ka administruar deri më tanë 1.5 milion doza të vaksinës kundër Covidit



PRISHTINË, 11 TETOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se Kosova ka administruar deri më tanë afér 1.5 milion doza të vaksinës kundër Covid-19, ndërsa rreth 640 000 qytetarë i kanë marrë të dyja dozat e vaksinës. "Me qëllim të arritjes më të shpejtë të objektivit për

vaksinimin e së paku 60 për qind të popullatës me vaksinën kundër Covid-19 dhe arritjes së imunitetit kolektiv, MSh-ja u bënë thirrje të gjithë qytetarëve të moshës mbi 16 vjeç që të vaksinohen pa asnjë hezitim. Gjithashtu, prindërit e fëmijëve të moshës prej 12-15

vjeç me indikacione shëndetësore të kujdesen për vaksinimin e fëmijëve të tyre", ka njoftuar MSh-ja. Kjo ministri ka theksuar se vaksinimi është rruga më e thjeshtë, më e shkurtër dhe më e sigurt për t'iu kthyer normalitetit.

Murati: Shteti do ta garantojë punësimin e secilit të ri që hyn në tregun e punës

PRISHTINË, 11 TETOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekura Murati, ka njoftuar se përmasen 1.4 e cila përfshinë skemën e punësimit të garantuar përmes rinjtë po jetësohet. Aktualisht jemi në zhvillim të platformës përmes së cilës do të mundësohet automatizimi i tjerë procesit. Zhvillimi i platformës po bëhet nga kompani vendore dhe me mbështetje financiare të

ri nga mosha 18 deri 24 vjeç. "Skema e punësimit të garantuar përmes rinjtë po jetësohet. Aktualisht jemi në zhvillim të platformës përmes së cilës do të mundësohet automatizimi i tjerë procesit. Zhvillimi i platformës po bëhet nga kompani vendore dhe me mbështetje financiare të

formalizimit", ka thënë Murati. Ai ka shtuar se pilotimin me sektorin privat do ta nisin me sektorin e IT-së, që do të fillojë sapo të funksionalizohet platforma. "Secila e re dhe secili i ri që hyn në tregun e punës do ta ketë punën e parë të garantuar nga shteti", ka theksuar ministri Murati.



Manipulim i shifrave të rritjes së GDP-së



Shkruan: Dardan SEJDIU

Muaj më parë ministri Murati kishte bërë një deklaratë të paparë nga asnjë ministër i Financave deri më tanë: tregonë shifrat e rritjes ekonomike në terma nominalë. Për sqarim, rritja në terma nominalë përfshinë edhe efektin e rritjes së çmimeve (inflacionit) ndryshe nga rritja reale që e largon efektin e çmimeve, gjë që edhe një student i vittit të dytë në fakultet në Kosovë e di. Sidomos këtë vit çmimet janë rritur shumë, dhe këtë secili e di.

Kur e pati dhënë këtë deklaratë, nuk e tha asnjë fjalë përritjen reale - një tregues i cili përdoret nga secili ministër i Financave në botë, apo ministra që nuk manipulojnë.

Manipulimi i tij me të dhëna nuk ndalet këtu. Ky shkon tutje

dhe tenton të paraqesë rritjen e tremujorit të dytë si diçka e jashtëzakonshme, madje edhe si rezultat i ndikimit të qeverisë apo ministrisë së tij.

Kjo rritje, madje edhe më e madhe në shumë raste, ka ndodhur në të gjitha vendet në rajon. Për shembull, ekonomia e Shqipërisë gjatë tremujorit të dytë u rrit për 17.89 për qind. Ekonomia e Malit të Zi u rrit për 19 për qind, njëjtë sa ekonomia e Maqedonisë. Vetëm ekonomia e Serbisë dhe ajo e Bosnjës dhe Hercegovinës u rriten nga 13.7 dhe 14.7 për qind.

Mirëpo prapësepapë rritja e ekonomisë sonë gjatë kësaj periudhe është nen nivelin mesatar të këtij rajoni (Western Balkan 6, përjashto Kosovën). Arsyja përritje, edhe pse

nën mesataren e rajonit tonë, është shumë e thjeshtë: gjatë tremujorit të vitit të kaluar çdo ekonomi pothuajse ishte e mbyllur, dhe kur e krahason aktivitetin ekonomik të tremujorit të dytë të këtij viti me atë tremujor, është shumë e pritshme që të ketë rritje të këtij niveli.

Ndërsa përritje të treguar që kjo rritje është pothuajse tërësisht e shtyrë nga sektori privat dhe nga ardhja masive e diasporës sivjet, mjafton të analizohen të dhënat fiskale nga uebfaqja e Ministrisë së Financave.

Aty del se në fund të muajit gusht (të dhënat më të fundit) Qeveria e Kosovës në konton e vet bankare ka rrëth 500 milionë euro. Duke parë trendin ngritës të bilancit bankar të muajve të fundit,

lirisht mund të parashikohet se kontoja e shtetit tonë në fund të shtatorit mund të ishte rrëth 600 milionë euro.

Ende më keq, kjo lojë arrin kulminacionin kur publikisht krahason rritjen "reale" ekonomike të parashikuar nga Banka Botërore prej 7.1-përqindësh me shifrën e famshme "nominale" prej 7.9-përqindësh. Këto dy shifra janë dy gjera krejtësisht të ndryshme dhe përritje arsyesh nuk krahason. Le të themi se Kosova prodhon vetëm molla, dhe në vitin 2020 nga prodhimi i mollëve kishte arritur një GDP nominale prej 100 milionë eurosh.

Këtë vit çmimi i një molle ishte 1 milion euro. Ne vitin 2021 arrin të shesë plot 105 molla, mirëpo me çmim të ngritur në

gati 1.05 milionë euro përmollë. Rritja nominale në këtë vit është pak mbi 10 për qind. Mirëpo kur mënjanohet efekti i çmimit (ngritja nga 1 në 1.05 milionë euro përmollë) del se rritja reale (dmth. në kuantitet të produkteve apo edhe shërbimeve në botën reale) është vetëm 5 për qind.

Kështu, pra, ministri Murati manipulon me koncepte bazike të ekonomisë. Sigurisht që rritja ekonomike e sivjetshme mund të jetë mbi 7 për qind, siç thotë edhe Banka Botërore, mirëpo rritjen ekonomike nuk e ndihmon dot as manipulimi me të dhëna e as spektakli me numra të komunave!

Sektori privat dhe diaspora janë meritorët përritje ekonomike, e jo qeveria dhe kursimet e saj.

PDK-ja kërkon nga qeveria ta rishikojë vendimin për projektin amerikan të gazsjellësit

PRISHTINË, 11 TETOR - Shefi i grupit parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, pas përfundimit të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, e cila është

mbajtur të hënën, ka kërkuar nga qeveria Kurti ta rishikojë vendimin për projektin amerikan të gazsjellësit. Ai ka thënë se refuzimi i këtij projekti do t'i shkaktojë dëme të mëdha

shtetit tonë. "Ne i kërkohmë qeverisë që ta rishikojë edhe një herë vendimin sa i përket gazsjellësit. Alternativat gjithmonë janë të rëndësishme, aq më shumë që po flasim për

një projekt që financohet nga ShBA-ja që kap vlerën e 200 milionë dollarëve. Refuzimi i Qeverisë së Kosovës i bën dëm të madh vendit", ka dekluaruar Tahiri.



Diktaturat nuk janë më të aftë se sa demokracitë në përballimin e krizave

Nga Justin ESAREY
"The Atlantic"


Idea se diktaturat i bëjnë gjërat më me vendosmëri, ndërsa demokracitë luhaten përballëkrizave, ka një origjinë të lashtë, dhe një simpati të qëndrueshme. Kur Republika e lashtë Romake përballej me kohëra të vështira, Senati caktonte në krye një burrë të fortë me kompetencia praktikisht të pakufizuara (por me një mandat të përkohshëm në detyrë) për ta menaxhuar krizën.

Abraham Lincoln, shpëtimtari i demokracisë amerikane dhe Emancipuesi i Madh, pezulloi zbatimin e ligjeve dhe burgosi arbitralisht kundërshtarët e tij, për të ruajtur vendosmërinë e Unionit përfitor në Luftën Civile Amerikane. Thuhet se diktatori itali Benito Mussolini "i bëri trenat të mbërrinin më përpikëri në stacione".

Nga ana tjetër, disa pretendojnë se demokracitë nuk mund të bëjnë gjithmonë të njëjtën gjë. Dhe argumenti se qeveritë autoritare i tejkalojnë demokracitë në një kohë krize, ka rishfatur terren gjatë pandemisë së koronavirusit, sidomos brenda qeverisë kineze.

"Global Times", një gazetë e botuar nga Partia Komuniste Kinez, deklaroi hapur se vendet perëndimore "dështuan ta parandalojnë përhapjen e virusit në vendet e tyre ... si rezultat i sistemeve të tyre të qeverisjes", dhe se "Perëndimi nuk mund të ketë një qeveri aq të fuqishme sa ajo e Kinës".

Në fakt, vdekjet e raportuara nga Kina prej Covid-19 janë jashtëzakonisht të ulëta, pak më shumë se 5.700 në një vend me më shumë se 1 miliard njerëz. Po ashtu gazeta kinezë shkruante se "përparësitë sistematike, përfshirë qeverisjen efektive nga lart-poshtë, e kanë menaxhuar më mirë Covid-19, mund të shpjegojë pjesërisht arsyen pse qeverisja në të gjithë botën është bërë më autokratike që nga fillimi i pandemisë. Njerëzit dëshirojnë veprime vendimtare.



politologu i njohur amerikan Francis Fukuyama, mendon se fajtore nuk është domosdoshmërisht demokracia, por sipas tij "nëse qytetarët i besojnë udhëheqësve të tyre, dhe nëse këta udhëheqës drejtojnë një shtet kompetent dhe efektiv", kjo është vendimtare për të mposhtur një pandemi.

Idea se shqëritë e drejtuara nga lart-poshtë, e kanë menaxhuar më mirë Covid-19, mund të shpjegojë pjesërisht arsyen pse qeverisja në të gjithë botën është bërë më autokratike që nga fillimi i pandemisë. Njerëzit dëshirojnë veprime vendimtare.

Ata që tek demokracitë u rezistojnë masave të forta, siç janë vendimet për vaksinimin e detyrueshëm, përmendin shpesh të drejtën e tyre përliri personale, pavarësisht faktit se programet e vaksinimit të detyrueshëm janë etikisht dhe historikisht të pajtueshme me demokracinë.

Ndërkohë, mediat perëndimore raportojnë se "Amerika ka dështuar në veprimet kolektive, apo se "SHBA-ja nuk ka arritur t'i bindë amerikanët që të vaksinohen". Edhe Francis Collins, drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetit në SHBA, është shprehur se Amerika po "dështon" në përballimin e Covid-19, për shkak të niveleve të ulëta të vaksinimit.

Presioni që krijon një kritikë e tillë tek qeveritë demokratike, që ato të janë më autoritare, duhet të jetë shumë i madh. Gjithsesi në vitin 2020, shumica e vendeve që ishin etiketuar si "të lira" nga Freedom House qëndruan po të tillë: Reduktimet e të drejtave politike dhe lirive civile, u panë

kryesisht tek diktaturat dhe regjimet hibride.

A duhet që bota t'i rikthehet diktaturës për të mposhtur pandeminë, dhe shumë sfida të tjera me të cilat përballemi? Edhe nëse diktaturat do të ishin më të afta sesa demokracitë në luftën kundër pandemisë, kjo nuk do të ishte një arsy e mjaftueshme për të zëvendësuar presidentët me byrotë politike, apo parlamentet me juntat ushtarake.

Liria, përfaqësimi i barabartë dhe të drejtat civile, janë më të rëndësishme sesa masat e shëndetit publik, të zbatuara në mënyrë të pamëshirshme. Por qeverisja efektive dhe e vendosur që supozohet se ofron autokracia, mund të jetë jo pak joshëse.

Por kjo bie ndesh me faktin se pavarësisht publicitetit negativ me të cilin janë përballur, demokracitë janë të paktën po aq efektive në vaksinimin e qytetarëve të tyre sa vendet jo-demokratike. Our World in Data, një bashkëpunim midis studiuesve në Universitetin e Oksfordit dhe Laboratorit të Dhënavë Globale, siguron informacione të përditësuara mbi proporcionin e qytetarëve të secilit vend, që kanë marrë të paktën një dozë të vaksinës kundër Covid-19, si dhe raport me PBB-në e tyre përfrymë.

Ekspertë nga Instituti V-Dem në Universitetin e Gotenburgut, i klasifikojnë regjimet në bazë të respektimit të tyre ndaj zgjedhjeve të lira, dhe mbrojtjes së të drejtave individuale, duke bërë të mundur krahasimin e performancës së regjimeve demokratike me atë të atyre autokratike. Në të njëtin nivel të prosperitetit

ekonomik, demokracitë janë mesatarisht të krahasueshme ose pak më mirë sesa homologët e tyre autokrate, sa i përket pjesës së popullsisë së tyre të vaksinuar. Disa demokraci kanë pasur një ecuri të dobët krahasuar me të ngashmit e tyre, por të tjerat janë shfaqur në lartësinë e detyrës.

E njëjtë gjë vlen edhe për diktaturat. Në fakt, edhe pse mund të duket befasuese për shumë njerëz, demokracitë e kanë vërtetuar se kanë avantazhe ndaj shumë aspekteve të kësaj krize, përfshirë kontrollin fillestar të përhapjes së virusit, dhe pajtueshmërinë e qytetarëve me masat e vendosura për të kufizuar transmetimin.

Po ashtu, ato janë më të afta në parandalimin e vdekjeve nga Covid-19. Demokracitë kanë raportuar vërtet më shumë vdekje nga sëmundja sesa autokracitë. Por këto raporte janë të komplikuara nga tendanca e autokrative për të falsifikuar të dhënat e tyre, me synimin që gjëjërat të duken më mirë nga sa janë në realitet.

Një mënyrë për ta kapërcyer atë problem, është të vlerësohet sa më shumë njerëz vdiqën në vitin 2020 (kur shpërtheu pandemia), në krahasim me vitet e mëparshme. Kjo është pikërisht ajo që bënë studiuesit Ariel Karlinsky dhe Dmitry Kobak.

Edhe pse vdekshmëria e tepërt, është një mekanizëm i papërsosur i llogaritjes së vdekjeve nga Covid-19, dhe i disponueshmëri më pak vende, sesa janë të dhënat e vdekshmërisë (Rusia është e përfshirë, por Kina jo), ajo është një e dhënë më e vështirë për t'u

falsifikuar.


Të dhënat e Karlinsky dhe Kobak, mund të përdoren për të krahasuar demokracitë me diktaturat, në përqindjen e tyre të vdekjeve të tepërtë gjatë pandemisë. Dhe në çdo nivel të PBB-së përfrymë, demokracitë paraqiten po aq mirë, dhe ndonjëherë më mirë se sa diktaturat.

Dëshira për një politikë të shpejtë, të unifikuar dhe të vendosur për të luftuar Covid-19, dhe për t'i dhënë fund kufizimeve të pafundme shëndetësore, është e kuptueshme. Por para se të përqafojmë autoritarizmin në emër të përshtatshmërisë, ne duhet të mos harrojmë se në kohën e Mussolinit trenat në Itali niseshin tamam në orar.

Përmirësimet e supozuara ishin pjesërisht mitike, pjesërisht i atribuoheshin nismave paraardhjes së fashizmit, dhe ishin të kufizuara vetëm në disa aspekte të sistemit hekurudhor. Përveç ishin regjime vrastare, Italia fashiste dhe Gjermania naziste ishin shumë të korruptuara, madje edhe kleptokratike.

Demokracitë përballen me kritika përfushat e tyre të vaksinimit, pikërisht sepse janë demokraci. Ato kanë kulturën e diskutimeve të hapura dhe mediave të lira. Por kur bëhet fjalë për zhvillimin dhe administrimin e vaksinave shpëtuese, që mund ta ndalin përhapjen e virusit, qeverisja demokratike duket se po funksionon.

Shënim: Justin Esarey, është profesor i asocuar i politikës dhe i çështjeve ndërkombëtare në Universitetin Ueik Forest. Bota.al



Kosova kërkon fitore ndaj Gjeorgjisë

Përzgjedhësi Bernard Challandes i dhe sulmuesi Vedat Muriqi kanë paralajmëruar se Kosova do të sigurojë fitore ndaj Gjeorgjisë në ndeshjen e Grupit B që zhvillohet sonte (e martë) në stadiumin "Fadil Vokrri". "Dardanët" pozicionohen në vendin e katërt në grup me vetëm katër pikë të grumbulluara

EPOKA
ERE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 TETOR - Fitorja është synim i Përfaqësueses së Kosovës në futboll në ndeshjen që e zhvillon sonte (e martë) ndaj Gjeorgjisë. "Dardanët" në këtë ndeshje vijnë pas humbjes nga Suedia (3-0), por besojnë në fitore përfaktin se një të tillë e arritën edhe si mysafrë ndaj këtij kundërshtari me rezultat minimal 0-1.

Përzgjedhësi Bernard Challandes ka paralajmëruar lojë ofensive në ndeshjen ndaj Gjeorgjisë, por edhe ndaj Greqisë në muajin nëntor. "Synimi ynë është gjithmonë që të luajmë lojë ofensive dhe të krijojmë posidim më të lartë të topit. Këto paraqitje synojmë t'u bëjmë gjatë tri ndeshjeve që kanë mbetur, përfshirë miqësoren që do ta zhvillojmë në nëntor. Këto ndeshje do të na ndihmojnë që të jemi sa më të gatshëm përfshirë Ligën e Kombeve që fillon në vitin e ardhshëm", ka thënë Challandes, i cili ka pranuar se nuk ishte i kënaqur me ekipin në ndeshjen e së shtunës ndaj Suedisë.

Trajneri zviceran, po ashtu, ka konfirmuar se anësori Lirim Kastrati është i gatshëm përfshirë ligën e kombeve që fillon në vitin e ardhshëm, ka thënë Challandes, i cili ka pranuar se nuk ishte i kënaqur me ekipin në ndeshjen e së shtunës ndaj Suedisë.

Gjeorgjisë, ka shtuar ai. Strategu zviceran në konferencën përmjet media është pyetur se a do të japë dorëheqje pas rezultateve negative. Challandes ka thënë se nuk është ai që vendos nese do të largohet. "Unë jam i kënaqur me këtë ekip dhe kurri nuk frikësohem nga shkarkimi. Nëse Federata e sheh të arsyeshme, atëherë në rregull por, nese e sheh të arsyeshme përfshirë ta vazhduar bashkëpunimin, nuk ka problem. Prej ditës së parë kur kam firmosur kontratën e kam pasur të qartë se çdo ditë është mbijetesë. Unë kam mbijetuar ditë pas dite, ndeshje pas ndeshjeje. Shpresoj që të mbijetojë edhe të martën, pastaj do të shohim se çfarë do të ndodhë", ka dekluaruar Challandes.

Në konferencën përmjet ndeshjen ndaj Gjeorgjisë ishte edhe sulmuesi i Lazio, Vedat Muriqi, i cili bën me dije se "dardanët" luajnë përfshirë. "Nuk kemi luajtur mirë ndaj Suedisë. Si ekip kemi kualitet përfshirë më shumë. Ndaj Gjeorgjisë duhet të fitojmë, edhe pse nuk e nënçmojmë kundërshtarin përkundër që kemi fituar në udhëtim. Na pret një ndeshje e vështirë, por kemi analizuar mirë kundërshtarin dhe futemi në fushë përfshirë ta fituar ndeshjen", ka thënë Muriqi. Kosova është e katërtë në grup me vetëm katër pikë të grumbulluara.

SHKURT

MVP dhe pesëshja e xhiros së pestë

Xhiroja e pestë në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll ka dhuruar ndeshje interesante. Pa dyshim sfida më dramatike ishte ajo ndërmjet Sigal Prishtinës që u vendos në sekondat e fundit. Ishte pikërisht Dachon Burke i cili shënoi një trepikësh përfundimtar 86:83. Por, jo vetëm kaq. Burke kishte 33 pikë, shtatë kërcime dhe katër asistime në këtë ndeshje, me indeksin e lojës 35. Dachon Burke ishte lojtari i ndeshjes dhe zgjidhet edhe i javës në Art Motion Superligën e Kosovës në basketboll. Ndërkohë, top pesë lojtarët me efektshmërinë (indeksin) më të lartë në xhiron e pestë ishin: Barret Benson i Golden Eagle Yllit 41, Gëzim Morina i Golden Eagle Yllit 37, Dachon Burke i Sigal Prishtinës me 35, Nick Banyard me 32 dhe Julien Lewis i Bashkimit me 30.

Begolli largohet nga Vëllaznimi

Trajneri Granit Begolli edhe zyrtarisht më nuk do të jetë trajner i skuadrës së Vëllaznimit nga Gjakova. Lajmin e ka bërë me dije vetë Begolli në profilin e vet në "Facebook". "Nuk do të jem pjesë e KF Vëllaznimi, kam dhënë dorëheqje nga pozita e trajnerit. Së pari duhet ta falënderoj qytetin e Gjakovës përmikpritjen dhe sjelljen shumë korrekte ndaj meje, po ashtu falënderoj tifozët përmblështetjen, bashkëpunëtorët e mi Luan Tabakun, Valon Kasapin, Daim Xhepen dhe të tjerët që punuan në klub. Mbi të gjitha, dua t'i falënderoj futbollistët që ishin fantastikë gjatë kësaj kohe sa kaluan së bashku, sepse pa ta unë si trajner nuk do të kisha këto rezultata. Mirupafshim Gjakovë!", ka shkruar Begolli.

KB Rahoveci ndërpret bashkëpunimin me trajnerin Fotis Takianos

KB Rahoveci ka njoftuar se me marrëveshje të dyanshme kanë ndërrprerë bashkëpunimin me trajnerin grek Fotis Takianos. Pas një fillimi jo të mirë këtë sezon, Rahoveci ka vendosur t'i ndajë rrugët me Takianos. Zëvendësuesi i Takianos do të jetë ndihmësi aktual Illmen Bajra. "Me marrëveshje të dyanshme kemi ndërrprerë bashkëpunimin me trajnerin grek Fotis Takianos. E falënderojmë përfshirë teksta i urojmë çdo ditë të mirë në jetë e karrierë. Zëvendësuesi i tij do të jetë ndihmësi aktual Illmen Bajra. Me këto ndryshime klubi synon të rikthehet në normalitet pas rezultateve të fundit", thuhet në njoftimin e Rahovecit.

GRUPI A

20:45 Portugali - Luksemburg
20:45 Serbia - Azerbajxhan

GRUPI B

20:45 Kosova - Gjeorgjia
20:45 Suedi - Greqi

GRUPI C

20:45 Bullgaria - Irlanda Veriore
20:45 Lituanja - Zvicra

GRUPI D

16:00 Kazakistani - Finlanda
20:45 Ukraina - Bosna dhe Hercegovina

GRUPI F

20:45 Danimarka - Austria
20:45 Ishujt Farore - Skotlanda
20:45 Izraeli - Moldavia

GRUPI I

20:45 Shqipëria - Polonia
20:45 Anglia - Hungaria
20:45 San Marino - Andorra

Shotani merr drejtimin e Istogut

Istogu, 11 tetor - Skuadra e Istogut e ka paraqitur trajnerin e ri, Bekim Shotani. Ky i fundit ka nënskruar kontratë me "Troftat" deri në qershor të vitit të ardhshëm. "Bekim Shotani nënskroi sot kontratë me Istogut e cila është e vlefshme deri më 30 qershor 2022,

por me mundësi vazhdimi edhe për dy vjet të tjera. Trajneri Shotani besoi në projektin e klubit tonë dhe shpresojmë që së bashku në tre vjetët e ardhshëm me punë të madhe ta realizojmë atë", thuhet në njoftimin e skuadrës së Istogut. Trajneri vushtrias Bekim Shotani

do të ndihmohet nga stafi përcjellës me ndihmësit Mehdi Arifaj dhe Hysni Kabashi. Shotani është trajner i njohur në futbollin e Kosovës, ka udhëhequr skuadra të mëdha të Superligës siç janë Ballkani, Trepça '89, Llapi, Vushtrria, Drenica.



Reja dhe Berisha: Duhet ta mposhtim Poloninë

TIRANË, 11 TETOR - Trajneri Edi Reja është optimist se Shqipëria mund të mposhtë sone (e martë) Poloninë në kuadër të Grupit I kualifikues për Kupën e Botës. "Luajmë në shtëpi dhe duhet të jemi sa më të qetë, pasi kjo është rruga e vetme për të synuar fitoren. Duhet të tregojmë personalitet në ndeshje të tilla, por edhe fati është pjesë e rëndësishme dhe në Poloni ne nuk e patëm, pasi një episod penaltie na dëmtoi jo pak në atë transfertë. Duhet të luajmë të qetë dhe të bëjmë sa më pak gabime për ta arritur rezultatin që duam. Ne kemi një mënyrë loje që nuk ndryshon dhe e kemi përdorur thuaçse në të gjithë ndeshjet e fundit. Duhet të kemi kontrollin e lojës për të synuar fitoren, megjithatë varet edhe nga karakteristikat e kundërshtarit. Përmua është e rëndësishme që të mos rimë në mbrojtje, por të sulmojmë dhe të provojmë të marrim kontrollin e lojës", ka thënë Reja. Kapiteni i Kombëtares së Shqipërisë, Etrit Berisha, në konferencën para ndeshjes ndaj



Polonisë ka thënë se kuqezinjtë do të bëjnë lojën e vet dhe ta fitojnë ndeshjen. "Jemi të vetëdijshëm për situatën që jemi tani dhe luajmë një ndeshje të rëndësishme, por edhe nëse sigurojmë vendin e dytë, që na dërgon në 'play-off'. Në Evropian ka qenë më e lehtë, por ne do të bëjmë lojën tonë dhe shpresoj ta fitojmë këtë ndeshje. Në ndeshjen e radhës presioni nuk duhet të jetë mbi ne, por mbi Poloninë. Kemi bërrë shumë gjëra të mira deri tani, pavarësisht se si do të shkojë ndeshja, megjithatë shpresoj ta interpretojmë në mënyrën më të

mirë të mundshme. Ne duhet të japim maksimumin në fushën e lojës dhe të jemi të fokusuar për t'i zbatuar porositë e trajnerit. Ndaj tyre kemi bërrë shumë mirë në Poloni, por jemi ndëshkuar nga disa gabime, që nuk duhet t'i përsëritim. Duhet të gabojmë sa më pak dhe më pas të provojmë të shënojmë me kualitetet që kemi. Mund ta fitojmë, duke qenë se kemi edhe tifozët në stadium. Që do të na ndihmojnë jo pak", ka thënë Berisha. Shqipëria është e dyta në grup me 15 pikë, derisa Polonia është e treta me 14 pikë.

Ish-basketbollistet e njohura, vëzhguese në Superkupën Mbarëkombëtare

PRISHTINË, 11 TETOR - Superkupa Mbarëkombëtare në konkurrencën e femrave do të zhvillohet në Vlorë më 13 dhe 14 tetor në Vlorë. Kjo është hera e parë që Superkupa Mbarëkombëtare organizohet nga Liga Unike në konkurrencën e femrave. Në këto ndeshje vëzhguese do të jenë tri ish-basketbolliste të njohura. Vlora Braha dhe Anduena Rifati do të jenë në gjysmëfinale, kurse Edera Alibegaj në finale. Braha është ish-basketbolliste e Gjeneratës së Artë të Universitetit të Prishtinës, ku fitoi shumë trofe në basketbollin e Kosovës, është shprehur e nderuar



që do të jetë vëzhguese në editonin e parë dhe historik. Anduena vjen nga një familje sportistësh. Ajo ishte basketbolliste e dalluar e Bashkimit dhe mbrojtëse e ngjyrat e Kosovës. Anduena fitoi disa herë titullin e Kupën në Kosovë si dhe u zgjodh MVP, kurse katër herë është zgjedhur sportiste e vitit në Prizren

si dhe ka marrë çmimin e karrierës. Edera Alibegaj, po ashtu, është një emër i basketbollit shqiptar në konkurrencën e femrave. Edera ka qenë basketbolliste e dashur, duke përfaqësuar edhe Shqipërinë në garat ndërkombëtare, trajnere e dalluar, si dhe anëtarë e Bordit të Federatës Shqiptare të Basketbollit.

Wijnaldum: Nuk jam plotësisht i lumtur në PSG

Georginio Wijnaldum e ka pranuar se nuk është plotësisht i lumtur në Paris Saint-Germain, pas një fillimi të vështirë të jetës në Francë. PSG-ja e mori Wijnaldumin si lojtar të lirë verën që shkoi, pasi holandezit u largua

nga Liverpooli. Mesfushori holandez kishte luajtur rol kyç në ekipin e Liverpoolit që e arriti lavdinë në Ligën e Kampionëve dhe në Premierligë nën udhëheqjen e Jurgen Kloppit, por ai nuk ka qenë në gjendje të

zëre vend në "Parc des Princes" në fillim të sezont 2021/22. Ai ka folur haptazi për jetën e re në Paris, duke treguar se është i pakënaqur. "Nuk mund të them se jam plotësisht i lumtur. Kjo gjendje nuk është ajo që unë

doja. Në vitet e fundit kam luajtur shumë, gjithmonë kam qenë në gjendje të mirë fizike dhe kondicionale dhe kam luajtur mirë. Kjo është diçka ndryshe dhe duhet kohë për t'u mësuar me këtë. Mezi prisja ta bëja këtë

hapin e ri dhe pastaj ndodhi kjo. Është shumë e vështirë", ka thënë Wijnaldum. "Ky është futballi dhe unë duhet të mësohem ta përballoj këtë. Unë jam luftëtar. Duhet të punoj zellshëm", ka shtuar ai.

SHKURT

Enrique: Kemi luajtur në një nivel me kampionët në fuqi

Trajneri i Kombëtares së Spanjës, Luis Enrique, ka folur pas ndeshjes finale në Ligën e Kombeve me Francën ku spanjollët pësuan humbje me rezultat 2-1. "Ne shkojmë në shtëpi pa një kupë, por unë mendoj se kemi luajtur në një nivel me kampionët botërorë në fuqi, të cilët kanë potencial dhe cilësi të jashtëzakonshme fizike. Ne luajtëm lojën tonë si gjithmonë, duke shënuar në pjesën e dytë. Shanset për ta fituar ndeshjen ishin aty, por Benzema i shpiku ato gola dhe Franca fitoi", ka thënë Enrique. "Gjithsesi unë jam i lumtur dhe i kënaqur, madje edhe duke menduar për të ardhmen. Goli i Mbappes qëndron në timen, duke mos folur për asgjë që nuk mund ta kontrolloj. Do të doja të flisja për të, por nuk dua të bie në këtë kurth", ka shtuar Enrique.

Deschamps: Kemi cilësi dhe talent, por edhe shpirt të madh

Franca u shpall fituese e Ligës së Kombeve, duke mundur Spanjën me rezultatin 1-2. Pas kësaj fitoreje të rëndësishme për "Gjelat", shprehet i kënaqur edhe trajneri Didier Deschamps, i cili u shpreh se kjo fitore ishte e duhura dhe se ekipi i tij ishte përballur me dy kundërshtarë të fortë si në gjysmëfinale ashtu edhe në finale. "Ekipi ka karakter, kemi cilësi dhe talent, por përsëri nuk është e mjaftueshme sepse luajmë ndërkombëtarisht. Kjo fitore është e nevojshme sepse ne kemi luajtur kundër Belgjikës dhe Spanjës, dy skuadra të forta dhe me cilësi, por ne arritëm të shpalleshim fitues në Ligën e Kombeve", ka thënë Deschamps. Trajneri francez foli, gjithashtu, edhe për "Katar 2022" duke u shprehur: "Duhet të kualifikohemi. Kemi ende ndeshje për të luajtur, kur të jemi në 'Katar 2022' do të përgatitemi si të gjithë të tjerët".

Ylli i lakersve mungon dy muaj

Pa nisur mirë sezoni 2021-2022 kanë nisur problemet e para për ekipin e LA Lakers. Basketbollisti Trevor Ariza, i mbërritur këtë verë nga Miami, është dëmtuar në kavilje. Madje Ariza është operuar në kavilje dhe do të qëndrojë të paktën dy muaj pushim. Për pasojë, ai do të humbasë të gjithë fazën hapëse të sezont, me shpresën që të rikthehet për Krishtlindje. Ariza është një nga veteranët e ekipit kalifornian (36 vjeç), një përforsim i rëndësishëm i ardhur në merkaton e verës.

Lëndohet Varane

Lajme të këqija për trajnerin Ole Gunnar Solskjaer, pasi mbrojtësi i ardhur këtë verë të Manchester United, Raphael Varane është dëmtuar gjatë finales së Ligës së Kombeve në mes të Francës dhe Spanjës. Futbollisti ishte titullar i prapavijës së "gjelave", por qëndroi në fushë deri në minutën e 42-të, pasi pësoi një dëmtim muskulor dhe u zëvendësua nga mbrojtësi i Bayern Münchenit, Dayot Upamecano. Ende nuk dihet shkalla e dëmtimit, por prekja e kofshës është sinjal i një problemi muskulor që mund ta lëri mbrojtësin disa javë larg fushave të lojës. Nëse gjithçka konfirmohet, atëherë Solskjaer do të duhet ta rikthejë në formacion dyshen Maguire-Lindelof, që nuk është se ka ofruar shumë garanci gjatë sezont të kaluar.



Kompania Regionale e Mbeturinave "Ambienti" Sh.A. Pejë

Bazuar ne ligjin e Punës Nr.03/L-212 të dt. 02.11.2010 ,dhe në bazë të Udhzimit Administrativ Nr. 07 / 2017. Kryeshef Ekzekutiv i K.R.M. Ambinetit Sh.A. Pejë publikon këtë

KONKURS

Pozita: Menaxher në Njësin Operative Istog

Detyrat dhe përgjegjësia:

Nën mbikqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv është përgjegjës për :

- Funksionimin normal të infrastrukturek së Njësis Operative Istog
- Funksionimin e rregullt të mirmajtjes ,me shërbim të rregullt
- Implementimin e sukseseshem të projekteve investive nga donatorët
- Pergatitë raporte të rregulla javore dhe mujore
- Menaxhon në mënyrë të përgjegjishme me resurset njerzore
- Funksionim të rregullt të sektorëve të Njësis Operative Istog
- Për punën e tij i përgjigjet Kryeshef ekzekutiv

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara

Përveg kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të plotësojnë edhe këto kushte të veçanta:

- Të ketë së paku 5 vjet përvjohje pune në menaxhim
- Të ketë integritet të lart moral e profesional
- Njohja e punës me kompjuter

Procedurat për aplikim:

Kandidatët e interesuar duhet ti sjellin keto dokumenta për aplikim

- Diplomën universitare
- Biografinë (CV) e detajuar
- Letër motivimin
- Deklaratën nën betim
- Certifikatën që nuk është nën hetime
- Certifikatën shëndetshore

Aplikacionet merren në zyre qëndrore të KRM "Ambienti" Sh.A. Pejë

Dokumentet përcjellëse dorëzohen në Arkivine e kompanisë në pliko të myllur në zyre qëndrore të KRM AMBIENTIT Sh.A. Pejë.

Pozita – kerkohet me kohë te caktuar 3 vjeqare ,dhe me pune provuese prej 6 muajve Kandidatë te përzgjedhur në Listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor, dhe të njëjtin janë të obliguar të sjellin dokumentet origjinalë apo të Noterizuarë mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit intervistues. Afati për dorëzimin e aplikacioneve është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit .

Aplikacionet e dorzuara pas afatit të cekur me lartë dhe dokumentet jo të kompletuara do te refuzohen.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "ICON KOSOVA" SH.P.K. Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me numër Unik Identifikues: 810859952, me adresë në Prishtinë dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "ICON KOSOVA" D.O.O. iz Prishtina, donelo odluku o prestani rada sa nr: 810859952, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "ICON KOSOVA" L.L.C. in Prishtina has come to the decision to quit its business: 810859952 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement-publication.



Ndërmarrja Publike Lokale "Stacioni i Autobusëve "Sh.A.

FERIZAJ

Kryeshef Ekzekutiv i Stacioni Autobusëve Sh.A.Ferizaj në bazë të nenit 16 pika 1 të Statutit të kompanisë, Ligjit të Punës nr.03.L-212 neni 8 dhe 10 pika 2.2 Rregulloren mbi organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendve të punës dhe Organogramin , lidhur me plototësimin e vendit të punës, shpall:

KONKURS

ME KOHË TË CAKTUAR I VJET ME MUNDËSI VAZHDIMI

Për vendin e punës.

(I) ASISTENT/E E ZYRTARIT TË LARTË FINANCIAR

(II) SPIKER/ E – BILETAR/E

Kualifikimet e nevojshme:

Kërkesën dhe CV

- Shkolla e mesme
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipe
- Shkaktësi të shkëlqyeshme komunikuese
- Shkaktësi të shkëlqyeshme me kompjuter(Çertifikatën nga ndonjë institucion kredibil)
- Përvjohje e punës është e dëshirueshme
- Dëshmi se nuk është nën hetime

Vlerësimi dhe intervista do te bëhen pas përfundimit te afatit për aplikim. Lartësia e pagës për çaktohet në harmoni me politikat e Kompanisë. Kandidatët e interesuar mund të marrin aplikacionin në zyre e kompanisë N.P.L Stacioni i Autobusëve SH.A në Ferizaj dhe po në të njëjtin vend edhe mund ti dorëzojnë aplikacionet. Dokumentacionet e pa kompletuara nuk do te konsiderohet të vlefshme.Në intervistë do të stohen vetëm kandidatët të cilët do të hyjnë në listën e ngushtë, pas seleksionimit te dokumentacionit të paraqitur nga komisioni përkatës. Afati për dorëzimin e aplikacionit është 15 ditë nga dita e publikimit të konkursit prej orës 8:00 - 16:00.

Ferizaj, 11.10.2021

Kryeshefja Ekzekutive

Albulenë Çalaj
A. Çalaj



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Deshile Sulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Lumes " Vermice.

► Naile Sulaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Dëshmorët e Lumes " Vermice.

► Endrit Muja shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi " Prizren

► Leutrim Maralija shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu " Aziz Tolaj " Prizren.

► Lavdim Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë.

► Gerti Rugova shpall të pavlefshme deftesen e kl. X, XI, XII dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakove.

► Valdrin Halilaj shpall të pavlefshme dëftesën e kl. X, XI, XII dhe diplomën e shkollës se mesme Teknike " Nexhmedin Nixha" Gjakove.

► Visar Tabaku shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakove.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamet Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banës me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamet Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Mati 1" përbull "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banës me qira garsoniere në Ulpijan kati i parë, posedon tre shtëpier dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpijan kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banës me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladaora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola

Columbus, Georgia, USA
Since 1905

0.5L